

Silabusi i lëndës: **BIOGJEOGRAFIA**

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>			
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore</b>		
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>BIOGJEOGRAFIA</b>		
<b>Niveli:</b>	<b>Bachelor</b>		
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Zgjedhore</b>		
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>II/semestri III</b>		
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>2+1</b>		
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>4</b>		
<b>Koha / lokacioni:</b>	<b>E hënë: 8.45-10.15, Dep. Gjeografisë, salla 1</b>		
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Prof. asoc. dr. Valbon Bytyqi</b>		
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<a href="mailto:valbon.bytyqi@uni-pr.edu">valbon.bytyqi@uni-pr.edu</a> , <a href="https://sites.google.com/a/uni-pr.edu/valbonbytyqi/">https://sites.google.com/a/uni-pr.edu/valbonbytyqi/</a>		
<b>Përshkrimi i lëndës</b>			
	Biogjeografia është njëra nga degët e gjeografisë fizike e cila studion përhapjen e botës bimore dhe shtazore në Tokë. Kontinentet dhe oqeanet veçohen me kushte të ndryshme fiziko-gjeografike, andaj pasuria me botë bimore dhe shtazore është e lidhur ngushtë me kushtet e mjedisit. Në kuadër të këtij kursi, studenti do të kuptoj objektin e studimit dhe ndarjen e biogjeografisë, faktorët ekologjikë dhe ndikimin e tyre në përhapjen e botës së gjallë; tipat e vegjetacionit në Tokë, krahinat floristike dhe zoogjeografike.		
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Studenti të njoh objektin e studimit të Biogjeografisë; faktorët ekologjikë dhe rolin e tyre në përhapjen e botës së gjallë; të njoh dhe përcaktojë arealin e bimëve dhe shtazëve; të identifikojë karakteristikat kryesore dhe ligjshmëritë e krahinave floristike dhe zoogjeografike.		
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të njihet me objektin e studimit dhe ndarjen e Biogjeografisë.</li> <li>• Të kuptojë rolin e faktorëve ekologjikë (natyrorë) në përhapjen e bimëve dhe shtazëve</li> <li>• Të përcaktojë arealin e bimëve dhe shtazëve</li> <li>• Të identifikojë llojet kryesore bimore dhe shtazore të krahinave floristike dhe zoogjeografike.</li> <li>• Në fund të kursit, të dëshmojë me punim seminarik arealin e ndonjë bime apo shtaze në Kosovë.</li> </ul>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/ laboratorike	1	15	15
Punë praktike	3		3
Kontaktet me mësimdhënësin/ konsultimet	2		2
Ushtrime në teren			
Kollokuiume, seminare	3		3

Detyra të shtëpisë	2		2
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	10		10
Përgatitja përfundimtare për provim	2	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	3		3
Projektet, prezantimet, etj.	2		2
<b>Totali</b>			100 orë
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata tradicionale, mësim interaktiv me studentin në qendër, punë në grupe, diskutim, debate. Për ilustrim dhe përforsim të fakteve dhe koncepteve do të zgjedhën fotografi, ilustrime të ndryshme. Daljet në terren në të cilat do të konkretizohet njohja e karakteristikave biogeografike të terrenit.		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	40% vlerësimi i parë (java 8) 10% aktivitete në klasë, vijim i rregullt, detyrë seminari 50% provim final.		
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura bazë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. E. Hoxha &amp; B. Mustafa, "Fitoeкологи me fitogjeografi", Prishtinë, 2016.</li> <li>2. K. Misja – Zoogjeografia, shblu, Tiranë, 2010</li> <li>3. I. Ramadani, "Mjedisi jetësor", Prishtinë, 2011</li> </ol>		
<b>Literatura shtesë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Brown, J., Lomolino, M. – Biogeography, 7th ed., Sinauers associates, Inc Publisher, 1998.</li> <li>2. K. Buzo, "Gjeobotanika", SHBLU, Tiranë, 2005</li> </ol>		

<b>Plani i dizajnuar i mësimit - Ligjëratat:</b>		
	<b>Java</b>	<b>Ligjërata që do të zhvillohet</b>
16.9.2024	I	Biogjeografia, shkencë natyrore, lindja si shkencë, objekti, detyrat dhe metodat e studimit
23.9.2024	II	Vegjetacioni dhe ligjshmëritë e përhapjes së tij në natyrë
30.9.2024	III	Faktorët ekologjikë: drita dhe temperatura si faktorë ekologjikë (E. Hoxha... fq. 64-94)
7.10.2024	IV	Uji si faktor ekologjik; grupet ekologjike të bimëve ndaj ujit (E. Hoxha... fq. 124-158)
14.10.2024	V	Ndikimi i ajrit, tokës, orografisë dhe njeriut në bimë (E. Hoxha... fq. 159-180)
21.10.2024	VI	Fitocenozat - struktura, dinamizmi, klasifikimi (E. Hoxha... fq. 192-208)
28.10.2024	VII	Tipat e vegjetacionit në Tokë – tipi Lignosa, Herbosa dhe Deserta (E. Hoxha... fq. 213-250)
4.11.2024	VIII	Vegjetacioni i maleve të larta dhe i ujërave (E. Hoxha... fq. 251-

		269)
11.11.2024	IX	Fitogjeografia, areali, madhësia e arealit, forma, kufijtë dhe struktura e arealit (E. Hoxha... fq. 270-278)
18.11.2024	X	Krahinat floristike – Hollarktike (hemisfera veriore) (E. Hoxha... fq. 296-313)
25.11.2024	XI	Krahinat floristike – Neotrope, Paleotrope, Kapensis, Australisë, Antarktike, Oqeanike (E. Hoxha... fq. 313-325)
2.12.2024	XII	Zoogjeografia – fauna oqeanike (K. Misja: fq. 103-130)
9.12.2024	XIII	Fauna kontinentale – Notogjea dhe Neogjea (K. Misja: fq. 131-151)
16.12.2024	XIV	Fauna kontinentale – Paleogjea dhe Arktogjea (K. Misja: fq. 151-176)
23.12.2024	XV	Veçoritë biogjeografike të Kosovës (E. Hoxha...)

**Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

Vijimi i rregullt në ligjëratat dhe ushtrime është i obliguar si dhe respektimi i rregullave të mirësjelljes: mbajtja e qetësisë në mësim, shkyçja e telefonave celular, hyrja në sallë me kohë, etj.

**Mësimdhënësi i lëndës:  
Prof.asoc.dr. Valbon Bytyqi**